

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit E.C., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I.nr.1258/2013 të dt.24.03.15, pas shqyrtimit fillestartë mbajtur me datë 31.07.2018, në të cilën ish-in të pranishëm Prokurori i Shtetit–Hivzi Bajraktari, dhe i pandehuri E.C., gjykata në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: E.C., i biri i H., dhe Z., e gjinisë M., i lindur me dt. ... në K., KK K., me vendbanim në P. rr “A.B.” p/n, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, me punë të përkohshme në A., me numër personal ... i lëshuar nga MPB - RKS, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: prej datës së pa vërtetuar e deri më datë 08.11.2013 në shtëpinë e vet në rr. “Xh.A.” pn në P. në dhomën e fjetjes pa lejen e organit kompetent ka mbajtur një revole me gas të tipit Mod 92F, ngjyrë zezë, prodhim gjerman dhe 10 fishek të kalibrit 9mm-,

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,43,46,69,73,74,75, të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK –së, e gjykon:

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit E.C., i caktohet dënim me gjobë **prej 300(treqind) euro**, të cilin dënim është i obliguar t’u paguaj në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të zëvendësoj dënimin me gjobë ashtu që në ditë burgimi do të llogaritet me 20 euro gjobë të shqiptuar.

Obligohet i pandehuri që të paguajshpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 euro, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Komform nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPRK-së konfiskohet: një revole me gas e tipit Mod 92F, ngjyrë e zezë, prodhim gjerman dhe 10 fishek të kalibrit 9mm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.1258/2013 të dt.24.03.15, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin E.C., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Me datë 31.07.2018, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë çështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar aktakuzën PP/I.nr.1258/2013 të dt.24.03.15, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykoes pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform neni 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarojë i pafajshëm.

I pandehuri E.C., ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë më tej ka deklaruar citat *“unë këtë revole me gaz e kam blerë në Gj. ku atje janë legale, sepse në atë kohë punoja në Gj.. Unë atë revole e kam sjellur në Kosovë, pasi që e kam pasur në veturë, dhe e kam lënë në Kosovë, unë e kam harruar këtë faktë, në shtëpinë time në Kosovë kanë hyre hajnat shpesh, dhe në një rast ku unë e kam lajmëruar rastin se kanë vjedhur shtëpinë, policia kanë qenë në shtëpinë time, dhe kanë pare disa fishekë në tokë të cilët nuk i kanë marrur hajnat, dhe policia kanë pyetur a kam armë për këta fishekë, dhe unë ju kam treguar që kam, dhe unë potencialisht kam mundur me i thënë që nuk kam, se unë kam menduar që kjo është legale”*.

Prokurori i shtetit Hivzi Bajraktari ka deklaruar se: pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale si në aktakuzë, se pranimi i fajësisë është konform neni 248/1 të KPRK-së dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, andaj i ka propozuar Gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë, dhe njëherit me rastin e matjes dhe caktimin e llojit të lartësisë së dënimit të merr si rrethane lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjykata ka konstatuar se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPRK-së, I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban aktakuzën, siç janë: Lista e Evidencës e datë 09.11.2013, si dhe foto dokumentacioni që gjendet në shkresat tjera të lëndës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas neni 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethanave çanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurit, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim me gjobë si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandalohet të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjeneralë që të parandalohet personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor komform neni 69 të KPRK-së dhe 115 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komform neni 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikursenë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**

**Sekretarja Juridike:
Shqipe Rexhepi**

**Gjyqtari:
Arben Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.